



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

R. nr. 760/2024

Për:

Z. Avni Kastrati, Kryeshef ekzekutiv
Agjencia e Statistikave të Kosovës

Kopje:

Z. Habit Hajredini, Drejtor
Zyra e Kryeministrit-Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 30 qershor 2025

Qëllimi i raportit

1. Ky raport i Avokatit të Popullit ka për qëllim që të tërheqë vëmendjen e Agjencisë të Statistikave të Kosovës tek obligimi për t'i zbatuar parimet e miradministrimit, të përcaktuara me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA), në mënyrë që kërkesat dhe ankesat e qytetarëve të trajtohen me përgjegjshmëri, efikasitet dhe efektivitet dhe duke respektuar të drejtat e qytetarëve.
2. Ky raport po ashtu ka për qëllim që të sjellë në vëmendje të Agjencisë të Statistikave të Kosovës detyrimet e përcaktuara me Kushtetutë dhe me Ligjin 05/L-019 për Avokatin e Popullit, për t'u përgjigjur kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'ia paraqesë atij të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.

Baza ligjore

3. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 132, paragrafi 1, përcakton: *“Avokati i Popullit mbikëqyrë dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike”*. Ndërsa neni 135, paragrafi 3, i Kushtetutës përcakton: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*
4. Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ndër të tjerash, Avokati i Popullit ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - *“Për t'i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me Kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit (neni 16, paragrafi 1);*
 - *të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2);*
 - *t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.”* (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6).

Përmbledhje e fakteve dhe veprimet e Avokatit të Popullit

5. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 22 korrik 2024 ka pranuar ankesën e ██████████, parashtruar kundër Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) me pretendime për mospagimin e pagës së caktuar në bazë të kontratës së punës (regjistruar aktiv i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave).
6. Bazuar në shkresat që i kemi pranuar nga ankuesi, vërehet se ankuesi, më 28 qershor 2024, i është drejtuar ASK-së me letër në formë elektronike në postës elektronike: infoask@rks.gov.net. Ankuesi ka deklaruar se ASK-ja, përveç konfirmimit se është pranuar ankesa dhe njoftimit se e njëjta do të shqyrtohet nga ASK-ja, nuk ka marrë përgjigje lidhur me kërkesën e tij.

7. Më 26 dhjetor 2024 Avokati i Popullit iu drejtua me shkresë kryeshefit ekzekutiv të ASK-së dhe i kërkoi informata lidhur me pretendimet ankimore të paraqitura nga ankuesi, lidhur me mospagimin nga ana e ASK-së, sipas kontratës së punës, si dhe arsyet për mospërgjigje në kërkesën e datës 28 qershor 2024, paraqitur nga ankuesi, përkitazi me çështjen në fjalë.
8. Më 4 mars 2025 Avokati i Popullit i dërgoi një shkresë rikujtuese kryeshefit ekzekutiv të ASK-së.
9. Megjithatë, Avokati i Popullit nuk mori përgjigje në shkresat dërguar kryeshefit ekzekutiv të ASK-së.
10. Më 23 prill 2025 përfaqësuesi i Avokatit të Popullit kontaktoi ankuesin për të marrë informacione mbi zhvillimet e rastit. Ankuesi njoftoi se ende nuk mori përgjigje nga ASK-ja lidhur me kërkesën përkitazi me rastin e tij.

Vlerësimi i Avokatit të Popullit

11. Trajtimi i kërkesave nga organet e administratës publike të Republikës së Kosovës rregullohet me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA).
12. Parimet e miradministrimit janë të përfshira në LPPA, të cilat, mes të tjerash, obligojnë organet e administratës që të jenë efikase dhe efektive në përmbushjen e funksioneve të tyre në kohë dhe në mënyrë të organizuar, të jenë të përgjegjshme në trajtimin e kërkesave dhe t'i sqarojnë veprimet e tyre, t'i respektojnë të drejtat e qytetarëve për t'u informuar dhe për të marrë shërbim, të jenë transparente, si dhe nëpërmes përgjigjeve dhe shërbimeve të ofruara me kohë ta ndërtojnë besimin mes qytetarëve dhe organeve të administratës publike.
13. Organi i administratës publike, në këtë rast Agjencia e Statistikave të Kosovës, duhet të sigurojë që një vendim/përgjigje në shkresë të dërgohet brenda një afati kohor të arsyeshëm dhe pa vonesë.
14. Trajtimi, shqyrtimi dhe vendosja për kërkesë është obligim ligjor për autoritetin publik dhe në anën tjetër është e drejtë e çdo individ për trajtimin e kërkesës së tij/saj në përputhje me ligjin, nëpërmjet një procedure të rregullt ligjore dhe për marrjen e një përgjigje apo vendimi të bazuar në të drejtën e palës, të përcaktuar me ligj, si për procedurën e ndjekur, ashtu edhe për të drejtën në substancë.
15. Duke u nisur nga rrethanat e rastit, Avokati i Popullit konstaton se ASK-ja me mostrajtimin e kërkesës së ankuesit, të paraqitur më 28 qershor 2024, nuk veproi në pajtim me LPPA-në.
16. Përveç kësaj, ASK-ja nuk u është përgjigjur as kërkesave me shkrim të Avokatit të Popullit, të datave 26 dhjetor 2024 dhe 4 mars 2025, lidhur me informatat përkitazi me kërkesën e ankuesit.
17. Avokati i Popullit konstaton se ASK-ja ka dështuar të vepronte në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 132, paragrafi 3, sipas të cilit: *“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”*

18. Po ashtu, Avokati i Popullit konstaton se ASK-ja ka dështuar të vepronte në pajtim me neni 25 [Detyrimi i bashkëpunimit dhe pasojat e refuzimit], paragrafi 1, të Ligjit për Avokatin e Popullit, sipas të cilit: *“Të gjitha autoritetet kanë për obligim t’i përgjigjen Avokatit të Popullit në kërkesat e tij për zhvillimin e hetimeve, si dhe t’i ofrojnë ndihmë adekuate sipas kërkesës së tij.”*

19. Më tej, neni 24, paragrafi 4, i Ligjit për Avokatin e Popullit përcakton: *“Refuzimi apo dështimi për t’iu përgjigjur kërkesave të Avokatit të Popullit konsiderohet pengim i punës së Avokatit të Popullit. Kjo nuk e pengon Avokatin e Popullit për të nxjerrë konkludimet dhe rekomandimet e tij.”*

20. Për më tepër, neni 24, paragrafi 5, i Ligjit për Avokatin e Popullit përcakton: *“Avokati i Popullit mund të raportojë veprimet e parapara në paragrafin 4 të këtij neni në raportet e tij.”*

Duke u bazuar në rrethanat e cekura më lart, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (*“[...] ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*), në cilësinë e rekomanduesit i


REKOMANDON

Agjencisë së Statistikave të Kosovës:

- *Kërkesat dhe ankesat e qytetarëve t’i trajtoi në pajtim me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA).*
- *Ndaj kërkesave të Avokatit të Popullit për dokumente dhe informacione, të veprojë në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (neni 132, paragrafi 3) dhe në pajtim me Ligjin nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (neni 25, paragrafi 1).*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (*“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”*) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (*“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, [...] duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”*), ju lutemi të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerri lidhur me këtë çështje.

Me nderime,


Naim Qelaj
Avokat i Popullit